

Memorandum Bashkëpunimi

Për bashkëpunim dhe monitorim të nismës së Bashkise Kolonjë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kolonjë (ZVAP) me mbështetjen teknike të Projektit Bashki të Forta për keshillimin psiko – social për fëmijët e moshës 3-6 vjeç të arsimit parashkollor në Bashkinë Kolonjë

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit Nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kolonjë dhe Projektit Bashki të Forta si dhe akteve nënligjore për përballimin e situatës së krijuar në vend nga COVID-19, Bashkia Kolonjë, dhe ZVAP Kolonjë, nënshkruajnë këtë Memorandum Bashkëpunimi me qëllim përmbushjen efektivitetin e iniciativës. Në kuadër të situatës së krijuar në vend nga përhapja e virusit COVID-19 si dhe masave për të përballuar sa më mirë këtë situatë, Bashkia Kolonjë dhe Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kolonjë (ZVAP), me mbështetjen teknike të Projektit “Bashki të Forta”, vendosin aplikimin e këshillimit online “Unë të dëgjoj”.

Për këtë iniciativë, që ka për synim mbështetjen psiko-sociale të fëmijëve 3-6 vjeç përmes shërbimit të psikologut dhe angazhimit të mësuesëve e drejtuesëve të arsimit parashkollor, prindërve dhe institucionit të Bashkisë dhe ZVAP Kolonjë, janë përcaktuar detyrat për të gjithë aktorët e përfshirë.

1- Bashkia Kolonjë ZVAP Kolonjë me asistencë të projektit Bashki të Forta:

- Monitoron mësuesit e drejtuesit e arsimit parashkollor për mbajtjen e dokumentacionit në lidhje me rastet e ndjekura nga psikologu.
- Monitoron planet individuale të rasteve të ndjekura nga psikologu.
- Angazhon trupën e mësuesëve dhe drejtuesëve të arsimit parashkollor për të krijuar marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe psikologëve/punonjësve social si dhe bën ndërgjegjësimin e komunitetit në masmedia për rëndësinë e mbështetjes psiko-sociale në mirëqënien dhe zhvillimin e fëmijëve 3-6 vjeç.
- Përmes mjeteve online projekti Bashki të Forta mund të ofrojë asistencë për vendosjen e komunikimit online mes prinderit dhe psikologut me kërkesë të koordinatorit.

2- Përfshirja e mësuesit dhe drejtuesve të arsimit parashkollor në Bashkinë Kolonjë:

Nisur nga fakti që mësuesit dhe drejtuesit e arsimit parashkollor janë duke kryer mesimdhënien on line me prindërit (mesime, ushtrime të ndryshme) dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me ta, përmes grupeve që mësuesit kanë krijuar me prindërit, të informojnë këta të fundit për iniciativën që ka ndërmarrë Bashkia Kolonjë dhe ZVAP Kolonjë .

Mësuesit dhe drejtuesit e arsimit parashkollor:

- Janë urë lidhëse mes psikologut dhe prindit për të lehtësuar komunikimin mes tyre gjithmonë me lejen paraprake të prindërve.
- Për ata prindër të cilët nuk kanë mundësi, mësuesit marrin shënim problematikën që shprehin prindërit, numrin e telefonit, adresën e emailit si dhe emrin e kopshtit që fëmija ndjek dhe i'a përcjellin shqetësimin kordinatorit të shërbimit psiko-social të vendosur në dispozicion nga ZVAP Kolonjë nëpërmjet emailit aliubrikena@yahoo.com ose nëpërmjet numrit të telefonit të kordinatorit (i vendoset në dispozicion numri i telefonit të kordinatorit vetëm drejtuesve të kopshteve dhe shkollave që kanë kopshte në godinat e tyre) VASKË DEHURU 0697327680
- Mësuesit e arsimit parashkollor raportojnë çdo javë tek drejtori i kopshtit/shkollës për numrin e rasteve.
- Respekton standardet e konfidencialitetit dhe kodin e etikës, të miratuara nga MASR
- Angazhimi i aktorëve të sipërpërmendur konsiderohet pjesë e detyrimit ditor të punës

3- Koordinator i ZVAP Kolonjë

- Koordinator, nëpërmjet drejtuesit të arsimit parashkollor merr problematikat e prindërve për fëmijët, dhe i'a përcjell shqetësimin sipas kopshtit/shkollës psikologut që është përgjegjës për atë kopësht/shkollë .
- Raporton pranë Sektorit të Arsimit në Bashki ne adresën marildavivo@yahoo.com të premtën e çdo jave për numrin e rasteve të ndjekura, problematikat dhe se si është ndjekur rasti.

4- Psikologët e përfshirë në këtë proces:

- Marrin në ndjekje nga kordinatori i ZVAP çdo rast të fëmijëve të referuar nga drejtuesit e arsimit parashkollor.
- Harton një plan të mbështëtjes psikologjike për fëmijën dhe e ndan me prindin për t'u dakordësuar.
- Bën punë individuale online me fëmijën, sipas planit të dakordësuar me prindin.
- Vazhdon punën me fëmijën me dëshirën e fëmijës dhe prindit deri në arritjen e objektivave të vendosura në planin individual.
- Mban shënime rregullisht për të ndjekur ecurinë e fëmijëve.
- Zbaton me përpikmëri standardet e konfidencialitetit dhe etikës profesionale me fëmijën dhe prindin.
- Organizon seanca informimi online me prindërit për t'i udhëzuar ato për zhvillimin e aktiviteteve psiko-sociale në shtëpi.
- Raporton pranë kordinatorit në ZVAP të premtën e çdo jave për numrin e rasteve të ndjekura, problematikat dhe metodologjinë e ndjekur.

Ky Memorandum Bashkëpunimi i shpërndahet drejtuesve të arsimit parashkollor nga Drejtoria e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve pranë Bashkisë Kolonjë dhe drejtuesve të shkollave dhe psikologëve nga ZVAP Kolonjë

Shënim: Për çdo informacion të dhënë ruhet anonimat!

BASHKIA Kolonjë

Marilda VIVO



Handwritten signature in blue ink, appearing to read 'M. VIVO' with the date '02.10.20' written below it.

ZVAP Kolonjë

Viron CAUSHI

